

DETYRE PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:

"STUDIM PROJEKTIM RIKUALIFIKIMI I AKSESIT NDËRMJET LIQENIT TË PUKËS DHE REZERVUARIT KUKAJ"

Pukë, 2024

Bashkia e Pukës, kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studim projektimin) për objektin: Studim Projektimi "**Rikualifikimi i aksesit ndërmjet liqenit të Pukës dhe rezervuarit Kukaj**". Bashkia Pukë, me fond të parashikuar studim projektimi **4.390.643** (katërmilion treqind e nëntëdhjet mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë (pa tvsh) dhe afat realizimi **50 ditë** kalendarikë.

1. Rikualifikimi i aksesit ndërmjet liqenit të Pukës dhe rezervuarit Kukaj

1.1 Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Në qytein e Pukës dhe në afërsi të saj ndodhen dy rezervuare artificiale

- Rezervuari (Liqeni)iPukës
- Rezervuari (Ujëmbledhësi) Kukaj

Këto dy rezervuare kanë një largësi ndërmjet tyre prej 1.43 km



Rruga për këmbësorë ndërmjet këtyre dy liqeneve ndjek rrugën: 500m përgjatë rrjedhës së poshtme të liqenit të Pukës deri tek rruga nacionale e asfaltuar “unaza”, kysegment kalon nëpër një prroskë të pasistemuar ku në dy anët e saj është e gjelbruar me pemë të larta, vazhdon në 100m gjatësi përgjatërrugës auto “unazës” dhe ndahet nga “unaza” auto duke përshkruar trotuarin e rrugës së asfaltuar të lagjes Kukaj në 830m gjatësi, duke u takuar me liqeni (rezervuarin) Kukaj, në total kjo rrugë ndërmjet dy liqeneve është 1430m. Rruga ndërmjet dy liqeneve është një destinacion për shëtitje të përditshme nga qytetarët e Pukës, pamvarësisht kushteve jo të përshtatshme të saj.

✓ **Të dhënat e liqenit të Pukës:**


- Perimetri 959 ml
- Sipërfaqia ujore 31.779 m²
- Thellësia varion deri në 7-8 m
- Liqeni dhe bregu përreth saj është investuar nga Bashkia Pukë.

✓ **Të dhënat e Rezervuarit Kukaj:**

- Perimetri 3.216 ml
- Sipërfaqia ujore 302.785 m²
- Thellësia varion deri në 8-12 m
- Në këtë rezervuar ka patur punime investimi vetem tek vepra e shkarkimit dhe kanali vaditës, kurse përgatë bregut të saj uji i rezervuarit takohet me tokën natyrore.


1.2 Përshkrim i shkurtër i gjëndjes

Liçeni i Pukës.i rikualifikuar gjatë viteve 2016-2017 nga Bashkia Pukë me fondet e FSHZH-së. Nga investimi i bërë në këtë rezervuar është krijuar një “oaz” atraktiv për qytetarët dhe turistët që vizitojnë qytetin e Pukës.Është bërë pastrimi i saj nga mbetjet urbane, është ndërtuar një rrugë këmbësore me ndriçimin e saj e cila qarkon gjithë perimetrin e rezervuarit, në përroskën që furnizon me ujë këtë liçen ka një urë këmbësore funksionale (druri) dhe me efekt dekorativ, janë shtuar sipërfaqet e gjelbërta dhe lulishtet.Të gjitha këto elemente e kanë kthyer këtë rezervuar në një destinacion i cili pak nga pak po identifikon edhe qytetin e Pukës për nga bukuritë natyrore.



Ky rezervuarë ndodhet në hyrje të qytetit të Pukës nga ana lindore. Peisazhi përreth është i gjelbëruar dhe me bimë të larta, kryesisht bredh, qarkohet po nga lindja nga rruga auto hyrëse në qytet.

Rezervuari Kukaj. Ndodhet në distancën 1430 m larg liçenit të Pukës, me orjentim nga perëndimi i qytetit, qarkohet nga veriu nga rruga auto Pukë – Shkodër.



Rezervuari ka përdorim për vaditjen e tokave bujqësore të Njësisë Administrative Luf – Qerret të Bashkisë Pukë. Kyujëmbledhës është formuar nga relievi natyral i kodrave përreth ku nga ana perëndimore është ndërtuar një digë vogël me material vëndi. Rezervuari ndodhet pranë rrugës auto Pukë – Shkodër dhe nga lindja lidhet me rrugën e asfaltuar auto të lagjes Kukaj, bregu përreth rezervuarit është i butë pa ndonjë pjerrësi të theksuar. Në rezervuar bien tre përroska kryesore të cilat edhe furnizojnë atë me ujë, njëri nga drejtimi i lindjes nga lagjia Kukaj, tjetri nga veriu në drejtim të rrugës auto nacionale dhe një tjetër nga drejtimi i perëndimit. Peisazhi përreth ujëmbledhësit është gjelbëruar dhe ka bimësi të lartë, kryesisht pishë e zezë.

1.3 Kërkesa të projektit

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standartet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Objektivi i detyrës së projektimit është hartimi i projektit për rikualifikimin e bregut përreth ujëmbledhësit Kukaj si dhe lidhja e tij me liqenin e Pukës me rrugë për këmbësor, për të krijuar një park të ri pushimi për qytetarët vëndas dhe turistët, si dhe ndërmjet dy parqeve të ketë rrugë lidhëse për të apasionuarit pas ecjes dhe krijimin e aksesit lidhës për dy parqet me rrugë këmbësore, apo dhe korsi për biçikleta dhe vrapimi.

Rikualifikimi i rezervuarit është shumë i rëndësishëm pasipozicioni i saj i shtrire në një zonë të banuar i jep vlerë turistike për pushuesit vëndas dhe të huaj, nëpërmjet tij krijohet një ansambël turistik bashkë me liqenin e Pukës.

- Krijimi i rrugës për këmbësor përgjatë gjithë bregut të ujëmbledhësit Kukaj, kjo e shoqëruar edhe me korsi për biçikleta dhe vrapimi. Kjo rrugë të ruaj të njëjtën kuotë me kreshtën e digës prej dheu.
- Krijimi i rrugës për këmbësor ndërmjet dy liqeneve, duke ndjekur përroskën ku shkarkon tepërplotësi i liqenit të Pukës dhe sistemimi i kësaj përroske, duke ruajtur konfiguracionin e rrjedhës ujore në përroskë, ndjekja e segmentit të unazës dhe vazhdimi përgjatë trotuarit të rrugës auto të lagjes Kukaj, duke u bashkuar me rrugën e krijuar përgjatë ujëmbledhësit Kukaj.
- Krijimi i ndriçimit të rrugës.
- Krijimi i mini shesheve për pushim, me stola dhe ngrehina druri të hapura, tip verande të mbuluar me cati, për mbrojtjen e pushuesve nga reshjet e shiu të paparashikuara, si në rrugën e aksesit edhe në rrugën përgjatë ujëmbledhësit Kukaj.
- Krijimi i kanalizimeve për largimin e ujrave sipërfaqësore nga sipërfaqia e rrugëve dhe shesheve.
- Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta në zonat me erozion dhe pa bimësi përgjatë rrugës së aksesit ndërmjet dy rezervuarëve dhe përgjatë bregut të rezervuarit Kukaj.
- Identifikimi i rrjetit inxhinierik ekzistues dhe përmirësimi i sajë në zonat ku prek projektin e propozuar, me qëllim ruajtjen e funksionit të tyre, si ujësjellës, kanalizimi i ujrave të bardha dhe të zeza, rrjeti elektrik, kabllorët optik, etj.
- Projekti i konceptuar të jetë në harmoni me peisazhin dhe natyrën përreth

Per realizimin e detyrës së projektimit duhet të verifikohet gjendja në terren e objektit, të realizohet studim i gjeologjik dhe topografik, sidhetë kryhen konsultime me përfaqësuesit e Bashkisë.

Cilësia e hartimit të projektimit duhet të jetë e tillë që të realizohet detyra për të cilën po kryhet ky investim në standartin e kërkuar dhe të plotësojë kushtet e projektimit.

2. KËRKESAT QE DUHET TË ZGJIDHË PROJEKTI

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit: Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit.

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, exel, ëord etj.)

FAZA II Projekt ide paraprake

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në formë pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

- a. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, prerje tip të rrugës për secilin variant);
- b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)

c. Preventiv paraprak;

(Të paraqiten variantet e propozuara me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse)

Materialet dorëzohen në format hard copy (te printuara) dhe cd në formate soft copy (cad,exel, word etj.)

FAZA III Projekt ide përfundimtare

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas pranimit të variantit social-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt - idesë paraprake, procedohet me project – idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë:

- Raportin teknik;
- Preventivin e punimev, referuar portalit SIM (Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim), në platformën e-albania;
- Analizat teknike të çmimevetë marra nga platforma e-albania, për zërat, që nuk ndodhen në portalin “Manuali i çmimeve”.
- Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.
- Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- Rilevimi;

Projekt ideja duhet të përmbajë studimet e mëposhtme:

2.1 Relacioni teknik, kutëpershkruhen:

- Qellimi i ndërtimit, variantet e hartuara, krahasimi i tyre dhe justifikimi i variantit të zgjedhur, shpjegimi i përbërësve të varianteve;
- Studime hidrologjike, topografike, gjeologjike, hidrogeologjike objektit, përtëgjithëbasenit në ujëmbledhës dhe pjesën poshtë digave, deri atëherë kur objektidhe studimi topografik për zonën e projektit;
- Studimet e kryera për materialet e ndërtimit dhe karrierat që do të përdoren;
- Rjetirrigori objektidhe lidhja e tij me atë rajonal për periudhën e ndërtimit dhe frytëzimit;

2.2 Relacioni i bindikimit në mënyrë të rregullt të projektit, ndikimi në luginë dhe zonat kufi me basenit në ujëmbledhës.

2.3 Materiale grafike, të cilat të përmbajnë:

- planimetritë e bashkëvevendosjes së objektit dhe nënobjekteve, prerje gatësore, tërthore dhe detajet e tyre për të gjitha variantet e studiuara. Materiali të jetë i qartë dhe të krijojë një kuadër të plotë për njohjen e objektit;

Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, exel, word, etj.)

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, Cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit". Për këte për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e Projektit si dhe për aplikimin për lejendërtimi përmes portalit të Regjistrisë të integruar të Territorit, Të bashkepunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Pukë.

FAZA V: Projekti zbatimit: Perpuniimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

FAZA IV: Projekt zbatimi

Projekt zbatimi duhet të përmbajë:

1.1 Studimi hidrologjik dhe hidraulik, i pellgut ujëmbledhës

1.2 Studimi mbi materialet e ndërtimit përmban:

1.3 Studimi i llogaritjeve të objektit dhe nenobjekteve:

1.4 Studimi gjeologjik dhe gjeoteknik të zones

1.5 Studimet dhe materialet grafike përmbajnë:

1.6 Relievin e ujëmbledhësit në shkallë 1:5000, 1:10000, 1:25000 sipas madhësisë së tij.

1.6.1 Planimetrinë e detajuar të objektit dhe nenobjekteve (të bashkëvendosjes së tyre), si dhe të devijimit të përkohshëm.

1.6.2 Vizatime të detajuara me kuota absolute, në shkallë të pranueshme, të objektit dhe nenobjekteve, për një njohje të plotë të objektit dhe nenobjekteve që do të ndërtohen.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg, word, excel.

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në portalin SIM (Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim), të platformës e-albania

Për secilin zë punimi, i cili nuk ndodhet në portalin "Manuali i çmimeve", projektuesi duhet tihartojë analizat teknike të çmimeve po nga portal SIM nga platforma e-albania.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me fazë, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fugë, dhe logaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fugë për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga platforma e-albania, ku fondi rezervë të jetë (3 - 5)%.

3. Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje, në format soft copy dhe hard copy dhe 3 (tre) kopje në CD. Njëra nga kopjet do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në Cad, Excel, Word, Gis. Një nga këto kopje do të nevojitet për aplikim përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit.

Fondi i projektit për objektin Studim Projektimi "**Rikualifikimi i aksesit ndërmjet liqenit të Pukës dhe rezervuarit Kukaj**", Bashkia Pukë, ka parashikuar fondin prej **4.390.643** (katërmilion treqind e nëntëdhjet mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh. Objekti ka një afat realizimi 50 (pesëdhjetë) ditë kalendarikë.